



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.645/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, Burbuqe Fazliu nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Lipjanit, Burbuqe Fazliu nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Lipjan,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dega në Lipjan në Vendvotimet: 1333E/01D në Akllap, 1321E/02D në Gllogoc, 1304E/01R, 1304E/02R, 1304E/03R në Shalë, 1323E/01R Rufc i Ri, 1301x/04D Shkolla e Mesme Lipjan, 1322E/01R Dobrajë e Madhe, 1302E/02R, 1302E/03R Magure, 1307E/01R, 1307E/02R Gadime, 1301E/03R, 1301E/04R Shkolla Filllore Qendra në Lipjan

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 09.11.2017 në ora 13:10, nga Burbuqe Fazliu kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në komunën e Lipjanit nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Lipjan të cilën pretendon se pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) më datë 08.11.2017 ka vërejtur parregullsi nga ana e komisionerëve me të cilën sipas informative nga vëzhguesit dhe të afërmit e saj dyshon se votat e saj nuk iu janë numëruar fare apo janë bartur te kandidatët tjerë në vendvotimet 1333E/01D në Akllap, 1321E/02D në Gllogoc, 1304E/01R, 1304E/02R, 1304E/03R në Shalë, 1323E/01R Rufc i Ri,

1301x/04D Shkolla e Mesme Lipjan, 1322E/01R Dobrajë e Madhe, 1302E/02R, 1302E/03R Magure, 1307E/01R, 1307E/02R Gadime, 1301E/03R, 1301E/04R Shkolla Fillore Qendra në Lipjan. Parashtruesja e ankesës pretendon se është e bindur që në këto vendvotime ka ndodhur numrim jo i drejtë me të cilën si kandidatë për anëtare e Kuvendit Komunal në Lipjan është dëmtuar mbi 200 vota. Kërkon nga paneli që të evidentohet çdo shkelje në vendvotimet e lartpërmendura me të cilën janë bërë parregullsi gjatë numërimit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të sigurtë ka vërtetuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

PZAP-i vendimin e vet e bazon në dispozitën nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, nga si u tha mësipër në mbështetje të nenit 117.4, 115.1 dhe 118.1 e LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 645/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa